



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI SHTETËROR PËR KULTET

PROJEKT STUDIMOR 2

“MBI MARRËDHËNIET

SHTET – FE

NË NIVEL LOKAL”

(ZONA: SHQIPËRIA JUGORE)

2020

PËRMBLEDHJE

Projekti studimor me temë: *“Marrëdhëniet shtet – fe në nivel lokal”*, u ndërmorr me iniciativën e Komitetit Shtetëror për Kultet, nisur nga indiciet e mbledhura në takimet e shumta me përfaqësues të ndryshëm lokalë. Një studim i tillë që bëhet për herë të parë në vendin tonë, drejtohet nga një institucion shtetëror dhe synon të pasqyrojë gjendjen aktuale të marrëdhënieve, pa asnjë influencë me karakter politik apo fetar.

Parë në këndvështrimin e menaxhimit territorial, qëllimi i këtij projekti është:

- krijimi (aty ku nuk ekziston), nxitja dhe forcimi i bashkëpunimit mes aktorëve të ndryshëm shoqërorë, qofshin ata shtetërorë apo fetarë, për zgjidhjen e plagëve sociale, për mbështetjen e të rinjve në nismat për një perspektivë optimiste jete, për ruajtjen dhe promovimin e vlerave historike të bashkëjetesës fetare.
- pasqyrimi i problematikave me të cilat përballen përfaqësuesit e sipërpërmendur, në realitetin lokal, duke përcjellë shqetësimet dhe dëshirat për një përmirësim të situatës ndërrelacionale.
- shkallën e njohurive legislative dhe informacionit në fushën e fesë, si nga përfaqësuesit shtetërorë, ashtu edhe nga ata fetarë, me qëllimin final të mirëinformimit të tyre. Kjo për të siguruar e garantuar ushtrimin e së drejtës së fesë e besimit, si një e drejtë universale, themelore njerëzore.

Projekti është parashikuar të shtrihet në një periudhë kohore trivjeçare (2019-2021), me një shtrirje territoriale që mbulon të gjithë vendin, por të ndarë në tri zona gjeografike:

- Shqipërinë e Veriut (viti 2019),
- Shqipërinë e Jugut (viti 2020),
- Shqipërinë e Mesme (viti 2021).

Kjo ndarje gjeografike dhe kohore është kushtëzuar nga shtrirja e madhe territoriale dhe nga dëshira për t’u thelluar në marrjen e informacionit.

Ai është ndarë në tre faza:

- a) faza përgatitore e pyetësorëve, nëpërmjet të cilëve synohet të merret informacion sa më i besueshëm dhe real;
- b) faza në terren, që përfshin takimet dhe intervistat me përfaqësues lokalë laikë dhe fetarë;
- c) faza përfundimtare, e analizimit të të dhënave, nxjerrjes së konkluzioneve dhe dhënies së rekomandimeve.

Projekti është zhvilluar nëpërmjet një rrjeti kapilar, që ka përfshirë ndarjet administrative nga më të mëdhatë (qarqet, bashkitë, prefekturat) tek më të voglat (njësitë administrative, etj.), për të patur një pasqyrë reale të marrëdhënieve shtet – fe në nivel lokal. Gjatë këtij viti projekti mbulon

gjeografikisht pjesën jugore të territorit shqiptar, duke përfshirë qarqet: Gjirokastrë, Vlorë, Berat, Korçë, bashkitë dhe njësitë përkatëse administrative.

Marrja e informacionit është realizuar:

Së pari, me zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesit e institucioneve, shtetërore dhe bashkësive fetare.

Së dyti, me zhvillimin e intervistave direkte, “face - to – face”, me punonjësit/klerikët për marrëdhëniet ndërmjet pushtetit lokal dhe bashkësive fetare dhe si mund të përmirësohet më tej kjo marrëdhënie. Intervistat kanë qenë të strukturuar dhe semi - strukturuar, bazuar në pyetësorë të përgatitur paraprakisht me rigorozitet nga stafi i Komitetit Shtetëror për Kultet.

Në harkun kohor prej 4 muajsh janë mbuluar 116 njësi administrative dhe intervistuar 178 përfaqësues lokalë.

Ky projekt, që është vazhdimësi e atij të ndërmarrë vitin e kaluar, nga Komiteti Shtetëror për Kultet, u përqendrua në Qarqet: Berat, Gjirokastrë, Korçë dhe Vlorë. Duke ndjekur programin e miratuar, projekti iu nënshtua tri fazave, përkatësisht:


- 1) Fazës përgatitore, ku u mundësuan disa ndryshime në pyetësorët e përgatitur.
- 2) Fazës në terren, gjatë së cilës u realizua mbledhja e informacionit në rreth 300 takime direkte me përfaqësues të pushtetit vendor dhe përfaqësues fetarë.
- 3) Fazës përfundimtare, ku u përpunua gjithë materiali në zotërim dhe u përpilua paraqitja shkresore e projektit.

Duke iu përmbajtur idesë themelore mbi të cilën Komiteti Shtetëror për Kultet inicioi Projektin mbi marrëdhëniet mes shtetit dhe feve në nivel lokal, projekti i këtij viti pësoi disa ndryshime të lehta, nga i kaluari. Sigurisht, linja përcuese e pyetësorëve nuk u prek. Ndryshimet në formën e disa shtesave në pyetësorë, u diktuan nga nevoja që pyetësori të ishte sa më i kuptueshëm, pasi mungesa e tyre mund të krijonte mosdhënie shpjegimesh nga të intervistuarit. Qëllimi final ishte marrja e informacionit sa më të saktë e të detajuar, duke patur parasysh karakteristikat e panoramës fetare të zonave jugore të Shqipërisë.

Sa mësipër, pyetësori u shpërnda, shoqëruar me sqarimet e rastit, në një rrjet kapilar. Qarqet e sipërpërmendura, me 25 bashkitë dhe 102 njësitë administrative, u mbuluan gjatë studimit. Një pjesë e mirë e informacionit është mbledhur nga bisedat e lira, jashtë kontekstit të plotësimit të pyetësorëve, për t’u krijuar mundësinë të intervistuarve, të shpreheshin lirisht. Ky lloj materiali i përmbledhur, pasqyrohet në kapitujt në vijim. Të gjitha të dhënat konsiderohen shumë të vlefshme për arritjen e qëllimit kryesor për të cilin zhvillohet studimi, ai i krijimit dhe/apo përmirësimit të raportit bashkëpunues mes shtetit dhe feve, në të mirë të komuniteteve lokale.

QARKU I KORÇËS

Qarku i Korçës përmbledh administrativisht Bashkitë: Korçë, Devoll, Kolonjë, Maliq, Pogradec dhe Pustec, së bashku me 37 Njësi Administrative. Në nivel institucional, bashkësitë fetare përfaqësohen prej: Myftinisë së Korçës, Pogradecit dhe Devollit, që i përkasin Komunitetit Mysliman të Shqipërisë; Mitropolisë së Korçës që i përket Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë; Qendrave baritore të Administraturës Apostolike Jugore, që i përkasin Kishës Katolike në Shqipëri, Gjyshitës së Korçës, që i përket Kryegjyshitës Botërore Bektashiane dhe 37 Kishave të ndryshme që i përkasin Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë.



Ky qark i njohur historikisht për ndjenja të forta besimi, paraqitet me një panoramë fetare të larmishme, të shoqëruar me një përhapje e shtrirje gjeografike të konsiderueshme. Nisur nga kjo, pritshmëritë e nivelit të bashkëpunimit mes pushtetit vendor dhe feve të ndryshme janë të larta.

Duke patur parasysh qëllimin e projektit, modalitetet e zhvillimit të tij në këtë qark, u përqendruan në bisedat e lira dhe në intervistat e semi-strukturuara. U zhvilluan gjithsej 66 takime, prej të cilave u plotësuan në mënyrë vullnetare 66 pyetësorë, të cilët trajtohen në vijim.


Në këtë kuadër u mbuluan zonat si mëposhtë:

1. Prefektura Korçë
2. Bashkia Korçë (7 njësi administrative)
3. Bashkia Devoll (4 njësi administrative)
4. Bashkia Pustec
5. Bashkia Kolonjë (7 njësi administrative)
6. Bashkia Pogradec (7 njësi administrative)
7. Bashkia Maliq (6 njësi administrative)

ANALIZA E TË DHËNAVE


1.Vendbanimi

Nga 66 persona të intervistuar në këtë qark, rezultojnë se: 41 % (n=27) e pjesëmarrësve janë nga Korça, 14 % (n=9) nga Maliqi, 12 % (n=8) nga Kolonja, 1.5 % (n=1) nga Pusteci, 21.2% (n=14) nga Pogradeci, 11 % (n=7) nga Devolli.




2.Gjinia

Përsa i përket gjinisë së pjesëmarrësve në këtë studim, rezulton se, 73 % (n=48) janë meshkuj dhe 27% (n=18) janë femra.




3. Mosha

Vërejmë se shpërndarja e pjesëmarrësve sipas grupmoshave është: 33% (n=22), i përkasin grupmoshës 25-35 vjeç, 27% (n=18) grupmosha 36-45 vjeç, 20% (n=13) grupmosha 46-55 vjeç, 18 % (n=12) grupmosha 56-65 vjeç, dhe 2% (n=1) i përkasin grupmoshës mbi 65 vjeç




4. Niveli i arsimit të kryer

Përsa i përket nivelit të arsimit të pjesëmarrësve në këtë studim, rezulton se, 68 % (n= 45) e tyre kanë kryer arsimin e lartë laik, 12.1 % (n= 8) arsimin e mesëm laik, 11 % (n= 7) arsim të lartë fetar, 5 % (n= 3) arsim të mesëm fetar, 1.5 % (n= 1) arsim profesional fetar dhe, 3 % (n= 2) kanë kryer arsim tjetër laik.




5. Institucioni që përfaqëson

Sipas të dhënave të mbledhuara, rezulton se, 67% (n= 44) e pjesëmarrësve përfaqësojnë institucione lokale shtetërore, 26 % (n= 17) e tyre përfaqësojnë institucione lokale të bashkësive fetare dhe, 7.6 % (n= 5) e tyre përfaqësojnë shoqata ose fondacionet fetare.



6. Përvoja në detyrë

Ndërsa, përsa i përket përvojës në detyrën aktuale që ushtrojnë, rezulton se 14 % (n=9) e pjesëmarrësve kanë përvojë 3-5 vite, 48 % (n= 32) mbi 5 vite, 14 % (n= 9) e tyre kanë 1-3 vite dhe, 24 % (n= 16) kanë më pak se 1 vit përvojë në detyrën që ushtrojnë.



7.

Descriptive Statistics					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
7.1.Sa i njohur jeni me të drejtat fetare të garantuara nga Kushtetura e Republikës së Shqipërisë? Ju lutem vlerësoni nivelin e njohurive tuaja me notë nga 1 në 3...	66	1	3	2.05	0.539
7.2.Sa i njohur jeni me marrëveshjet e nënshkruara midis Shtetit dhe bashkësive fetare në vend? Ju lutem vlerësoni nivelin e njohurive tuaja me notë nga 1 në 3...	65	1	3	2.18	0.583
7.3..Sa i njohur jeni me Ligjin Nr. 8788, dt,07.05.2001 'Për Organizatat Jofitimprurëse'? Ju lutem vlerësoni nivelin e njohurive tuaja me notë nga 1 në 3...	64	1	3	2.22	0.603
Valid N (listëise)	64				


Për këtë pyetje matjet janë realizuar me anë të shkallës Likert me tre pikë: (1- Dobët, 2 - Mirë, 3 - Shumë mirë).

- Për pyetjen e parë, e cila kishte për qëllim matjen e njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me të drejtat fetare të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, rezultoi se është arritur një mesatare prej 2.05 pikë nga maksimalja e mundshme që ishte 3.
- Për pyetjen e dytë, e cila ka për qëllim matjen e njohurive të pjesëmarrësve për marrëveshjet e nënshkruara midis Shtetit dhe bashkësive fetare, rezultoi se mesatarja e përfutur është 2.18 nga 3 që ishte maksimalja e mundshme.
- Ndërsa, për pyetjen e tretë, e cila synon të masë nivelin e njohurive të pjesëmarrësve për Ligjin Nr. 8788, dt,07.05.2001 'Për Organizatat Jofitimprurëse', nëpërmjet të cilit rregullohet aktiviteti i shoqatave dhe fondacioneve me karakter fetar që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vend, rezultoi se, mesatarja e përfutur është 2.22 nga 3 që ishte maksimalja e mundshme.

8. Sa është numri i bashkësive fetare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vendin tonë?

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat statistikore për njohuritë që ka i intervistuari në lidhje me numrin e bashkësive fetare të pranishme në Shqipëri.


		N	%
	3	1	1.5
	4	16	24.2
	5	32	48.5
	6	3	4.5
	Nuk e di	2	3.0
	9	1	1.5
Missing	Missing	11	16.7
Total		66	100.0



9. Numri i organizatave/shoqatave fetare që veprojnë në zone


Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat statistikore për njohuritë që ka i intervistuari në lidhje me numrin e organizatave/shoqatave fetare të pranishme në Shqipëri.

	N	%
1	3	4.5
2	6	9.1
3	15	22.7
4	12	18.2
5	6	9.1
6	1	1.5
7	3	4.5
8	6	9.1
9	1	1.5
15	1	1.5
Missing	12	18.2
Total	66	100.0




10. Si i perceptoni marrëdhëniet midis institucioneve shtetërore dhe institucioneve të bashkësive fetare në zonën tuaj? (Ins shtet.) Ju lutem vlerësojini këto marrëdhënie me notë nga 1 në 3...

Nga të dhënat, rezulton se marrëdhëniet mes institucioneve shtetërore kundrejt institucioneve të bashkësive fetare janë vlerësuar në masën 81.8 % (n= 54), si marrëdhënie bashkëpunuese, kortezie 9.1% (n=6) dhe të dobëta 6.1% (n=4), pa përgjigje 3% (n=2).




11. Si i perceptoni marrëdhëniet midis institucioneve të bashkësive fetare dhe institucioneve shtetërore në zonën tuaj? (Ins fetare.) Ju lutem vlerësojini këto marrëdhënie me notë nga 1 në 3...

Ndërsa, në marrëdhënien mes institucione të bashkësive fetare kundrejt institucioneve shtetërore janë vlerësuar në masën 75.8 % (n= 55) si marrëdhënie bashkëpunuese, kortezie 9.1% (n=6) dhe të dobëta 6.1 % (n=4), pa përgjigje 9% (n=6).



12. Sa është numri i takimeve të realizuara mes institucioneve shtetërore dhe bashkësive lokale fetare në vit?

	N	%
0	6	9.1
0-2	23	34.8
2-4	15	22.7
4-6	10	15.2
Më shumë se 6-të	7	10.6
Missing	5	7.6
Total	66	100.0




Midis institucioneve shtetërore dhe atyre fetare në nivel lokal, del se, mesatarisht realizohen 2.82 takime në vit.

Descriptive Statistics					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
12.Sa është numri i takimeve të realizuara mes institucioneve shtetërore dhe bashkësive lokale fetare në vit?	61	1	5	2.82	1.176
Valid N (listwise)	61				


13.Sa është numri i problematikave të ngritura nga bashkësitë fetare?

Për numrin e problematikave të ngritura në drejtim të institucioneve shtetërore, rezulton se, 30 % (n= 20) e tyre raportojnë 0-2 çështje, 15 % (n=10) nuk raportojnë të jenë ngritur problematika, 23% (n=15) raportojnë 2-4 raste, 3% (n=2) raportojnë 4-6 raste dhe 5% (n=3) raportojnë më shumë se 6 raste të ngritura nga bashkësitë fetare, 23% (n=15) janë përgjigjur nuk e di, dhe 1% (n=1) pa përgjigje.




14.Sa problematika të drejtuar institucionit tuaj janë zgjidhur përfundimisht?

Ndërsa, përsa i përket zgjidhjes së problematikave të ngritura, të intervistuarit raportojnë në masën 45 % (n= 30) se janë zgjidhur nga 0-2 prej tyre, 21% (n=14) nuk është zgjidhur asnjë rast, 11% (n=7) raportojnë 2-4 raste, 3% (n=2) raportojnë më shumë se 6 raste të ngritura nga bashkësitë fetare, 3% (n=2) pa përgjigje, 15% (n=10) janë përgjigjur nuk e di.




15.A ndjeheni të diskriminuar/menjanuar nga shteti?

Për sa i përket çështjes së pranisë së praktikave diskriminuese në marrëdhëniet midis institucioneve shtetërore dhe atyre të bashkësive fetare në nivel lokal, rezulton se subjekti pjesëmarrës ka raportuar në masën 74.2 % (49) negativisht dhe 12.1% (n= 8) pozitivisht. Ndërsa, 13.6 % (n= 9) shfaqet si vlerë e humbur, që nënkupton se i intervistuari ka refuzuar të përgjigjet.



16.Mendoni se ka favorizime në marrëdhëniet pushtet vendor-bashkësi fetare?

Nga ana tjetër, po ashtu, i intervistuari raporton në masën 60.6 % (n= 40) negativisht në lidhje me ekzistencën e praktikave favorizuese midis palëve. Ndërsa, 24.2 % (n= 16) e tyre, raportojnë pozitivisht.



Konkluzione

Nga tërësia e takimeve/intervistave u krijua ideja fillestare e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndërmjet bashkësive fetare dhe pushtetit vendor, dhe kjo u vërtetua edhe nga pyetësorët e plotësuar. Nga të dyja palët u shpreh marrëdhënia korrekte mes tyre dhe ndihma e marrë në raste të caktuara. Një problem i hasur në të gjitha bashkitë e prefekturës, është kthimi dhe kompesimi i pronave, problem i shprehur si nga bashkësitë fetare ashtu edhe nga pushteti vendor.

Vihet re se, qyteti Korçë përfaqësohet me numrin më të madh të pjesëmarrësve në pyetësor, duke u pasuar nga Pogradeci dhe zona e Kolonjës. Rreth 70 % e pjesëmarrësve janë meshkuj dhe pjesa tjetër femra dhe ku dominon, me 33 %, mosha mesatare 25-35 vjeç. Përfaqësuesit e institucioneve shtetërore përbëjnë 67 % të pjesëmarrësve në plotësimin e pyetësorit dhe, ata të bashkësive fetare 26 %. Kjo ndoshta shpjegon dhe faktin që, arsimi i lartë laik ka qenë arsimi i ndjekur nga 68 % e të anketuarve dhe vetëm 10 % arsimi i lartë fetar. Vjetërsia në punë përbën një fakt të rëndësishëm përsa i përket punës me bashkësitë fetare, pasi kjo ndihmon në njohjen më mirë të fushës së veprimtarisë së këtyre bashkësive dhe personave që i drejtojnë ato. Rreth 48% kanë mbi 5 vite punë në detyrë. Por pavarësisht këtij fakti vihet re një nivel mesatar njohjeje i bazës ligjore, sidomos i marrëveshjeve të nënshkruara mes shtetit dhe bashkësive fetare. Vetëm 48 % e të anketuarve e dinë se aktualisht janë 5 bashkësi fetare, 24 % mendojnë se janë 4 bashkësi fetare dhe rreth 16 % nuk janë përgjigjur. Kur bëhet fjalë për organizatat/ shoqatat fetare që operojnë në zonën e tyre, ka një mungesë të plotë informacioni nga të dyja palët. Kjo mund të jetë dhe si pasojë se në disa raste ka kisha ungjillore që nuk janë pjesë e Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë, por edhe sepse një pjesë e mirë e këtyre kishave nuk prezantohen si anëtare të saj. Vetëm rreth 23 % mendojnë se janë 3 organizata/shoqata fetare, 18% nuk janë përgjigjur, ndërsa pjesa tjetër japin përgjigje të ndryshme. Sikurse dhe nga bisedat paraprake dhe nga pyetësorët del se marrëdhëniet mes pushtetit vendor dhe bashkësive fetare janë të mira në nivelin bashkëpunues. Mesatarisht për këtë qark dalin që janë realizuar rreth tre takime në vit. Numri i problematikave të ngritura nga bashkësitë fetare varion në 0-2 problematika me rreth 30%, dhe 45 % raportojnë se janë zgjidhur në favor të bashkësive fetare 0-2 problematika. Si pushteti vendor dhe bashkësitë fetare raportojnë se nuk ka diskriminim apo favorizim mes tyre.

Për dy pyetjet e lira me diskutim, u vu re se, një pjesë kanë deklaruar se nuk kanë cfarë të shtojnë dhe një pjesë, sidomos nga bashkësitë fetare, kërkojnë që të zbatohen ligjet në fuqi si dhe zbatimi korrekt i marrëveshjeve të nënshkruara.

QARKU I VLORËS

Qarku i Vlorës përmbledh administrativisht Bashkitë: Vlorë, Selenicë, Himarë, Sarandë, Konispol, Finiq dhe Delvinë, së bashku me 13 Njësi Administrative. Në nivel institucional, bashkësitë fetare përfaqësohen prej: Myftinisë së Vlorës, Sarandës dhe Delvinës, që i përkasin Komunitetit Mysliman të Shqipërisë; Mitropolisë së Gjirokastrës që i përket Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë; Qendrave baritore të Administraturës Apostolike Jugore, që i përkasin Kishës Katolike në Shqipëri, Gjyshatës së Vlorës, që i përket Kryegjyshatës Botërore Bektashiane dhe 8 Kishave të ndryshme që i përkasin Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë.



Ky qark i njohur historikisht për ndjenja të forta besimi, paraqitet me një panoramë fetare të larmishme, të shoqëruar me një përhapje e shtrirje gjeografike të konsiderueshme. Nisur nga kjo, pritshmëritë e nivelit të bashkëpunimit mes pushtetit vendor dhe feve të ndryshme janë të larta.

Duke patur parasysh qëllimin e projektit, modalitetet e zhvillimit të tij në këtë qark, u përqendruan në bisedat e lira dhe në intervistat e semi-strukturuara. U zhvilluan gjithsej 50 takime, prej të cilave u plotësuan në mënyrë vullnetare 45 pyetsorë të cilët trajtohen në vijim.

Në këtë kuadër u mbuluan zonat si mëposhtë:


1. Prefektura Vlorë
2. Bashkia Vlorë (4 njësi administrative)
3. Bashkia Selenicë (5 njësi administrative)
4. Bashkia Himarë (2 njësi administrative)
5. Bashkia Sarandë (2 njësi administrative)
6. Bashkia Konispol (3 njësi administrative)
7. Bashkia Finiq (5 njësi administrative)
8. Bashkia Delvinë (2 njësi administrative)

Nga tërësia e takimeve/intervistave u krijua ideja fillestare e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndërmjet bashkësive fetare dhe pushtetit vendor, dhe kjo u vërtetua edhe nga pyetsorët e plotësuar. Nga të dyja palët u shpreh marrëdhënia korrekte mes tyre dhe ndihma e marrë në raste të caktuara. Një problem i hasur në të gjitha bashkitë e prefekturës, është kthimi dhe kompesimi i pronave, problem i shprehur si nga bashkësitë fetare por edhe nga pushteti vendor.

ANALIZA E TË DHËNAVE


1.Vendbanimi

Nga 45 persona të intervistuar në këtë qark, rezultojnë se: 27 % (n=12) e pjesëmarrësve janë nga Vlora, 7 % (n=3) nga Himara, 13 % (n=6) nga Selenica, 20 % (n=9) nga Saranda, 7% (n=3) nga Konispoli, 16 % (n=7) nga Delvina, 11 % (n=5) nga Finiqi.




2.Gjinia

Përsa i përket gjinisë së pjesëmarrësve në këtë studim, rezulton se, 71 % (n=32) janë meshkuj dhe 28.9% (n=13) janë femra




3.Mosha

Vërejmë se shpërndarja e pjesëmarrësve sipas grupmoshave është: 17.8% (n=8), i përket grupmoshës 25-35 vjeç, 31% (n=14) grupmosha 36-45 vjeç, 26.7% (n=12) grupmosha 46-55 vjeç, 20 % (n=9) grupmosha 56-65 vjeç, dhe 4.4% (n=2) i përket grupmoshës mbi 65 vjeç.




4. Niveli i arsimit të kryer

Përsa i përket nivelit të arsimit të pjesëmarrësve në këtë studim, rezulton se, 85 % (n= 38) e tyre kanë kryer arsimin e lartë laik, 2 % (n= 1) arsimin e mesëm laik, 11 % (n= 5) arsim të lartë fetar, 2. % (n= 1) arsim profesional laik.




5. Institucioni që përfaqëson

Sipas të dhënave të mbledhuara, rezulton se, 76% (n= 34) e pjesëmarrësve përfaqësojnë institucione lokale shtetërore, 22 % (n= 10) e tyre përfaqësojnë institucione lokale të bashkësive fetare dhe, 2.2 % (n= 1) e tyre përfaqësojnë shoqata ose fondacionet fetare.



6.Sa vite përvojë keni në këtë detyrë?



Descriptive Statistics					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
7.1.Sa i njohur jeni me të drejtat fetare të garantuara nga Kushtetura e Republikës së Shqipërisë? Ju lutem vlerësoni nivelin e njohurive tuaja me notë nga 1 në 3...	44	1	3	1.91	0.603
7.2.Sa i njohur jeni me marrëveshjet e nënshkruara midis Shtetit dhe bashkësive fetare në vend? Ju lutem vlerësoni nivelin e njohurive tuaja me notë nga 1 në 3...	41	1	3	1.98	0.612
7.3..Sa i njohur jeni me Ligjin Nr. 8788, dt,07.05.2001 'Për Organizatat Jofitimprurëse'? Ju lutem vlerësoni nivelin e njohurive tuaja me notë nga 1 në 3...	42	1	3	2.05	0.582
Valid N (listwise)	39				


Për këtë pyetje matjet janë realizuar me anë të shkallës Likert me tre pikë: (1- Dobët, 2 - Mirë, 3 - Shumë mirë).

- Për pyetjen e parë, e cila kishte për qëllim matjen e njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me të drejtat fetare të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, rezultoi se është arritur një mesatare prej 1.91 pikë nga maksimalja e mundshme që ishte 3.
- Për pyetjen e dytë, e cila ka për qëllim matjen e njohurive të pjesëmarrësve për marrëveshjet e nënshkruara midis Shtetit dhe bashkësive fetare, rezultoi se mesatarja e përfutur është 1.98 nga 3 që ishte maksimalja e mundshme.
- Ndërsa, për pyetjen e tretë, e cila synon të masë nivelin e njohurive të pjesëmarrësve për Ligjin Nr. 8788, dt,07.05.2001 'Për Organizatat Jofitimprurëse', nëpërmjet të cilit rregullohet aktiviteti i shoqatave dhe fondacioneve me karakter fetar që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vend, rezultoi se, mesatarja e përfutur është 2.05 nga 3 që ishte maksimalja e mundshme.

8.Sa është numri i bashkësive fetare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vendin tonë?

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat statistikore për njohuritë që ka i intervistuari në lidhje me numrin e bashkësive fetare të pranishme në Shqipëri.

		N	%
Valid	2	1	2.2
	3	2	4.4
	4	8	17.8
	5	19	42.2
	6	3	6.7
	9	1	2.2
	10	2	4.4
Missing	Missing	9	20.0
Total		45	100.0




9.Sa është numri i organizatave/shoqatave fetare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në zonën tuaj?

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat statistikore për njohuritë që ka i intervistuari në lidhje me numrin e organizatave/shoqatave fetare të pranishme në Shqipëri.


	N	%
1	3	6.7
2	5	11.1
3	9	20.0
4	4	8.9
5	8	17.8

6	1	2.2
7	6	13.3
14	1	2.2
15	1	2.2
Missing	7	15.6
Total	45	100.0




10. Si i perceptoni marrëdhëniet midis institucioneve shtetërore dhe institucioneve të bashkësive fetare në zonën tuaj? (Ins shtet.) Ju lutem vlerësojini këto marrëdhënie me notë nga 1 në 3...

Nga të dhënat, rezulton se marrëdhëniet mes institucioneve shtetërore kundrejt institucione të bashkësive fetare janë vlerësuar në masën 76 % (n= 34), si marrëdhënie bashkëpunuese, kortezie 20% (n=9) dhe të dobëta 4% (n=2).




11. Si i perceptoni marrëdhëniet midis institucioneve të bashkësive fetare dhe institucioneve shtetërore në zonën tuaj? (Ins fetare.) Ju lutem vlerësojini këto marrëdhënie me notë nga 1 në 3...

Ndërsa, në marrëdhënien mes institucione të bashkësive fetare kundrejt institucione shtetërore janë vlerësuar në masën 73% (n= 33) si marrëdhënie bashkëpunuese, kortezie 22% (n=10) dhe të dobëta 5 % (n=2).



12. Sa është numri i takimeve të realizuara mes institucioneve shtetërore dhe bashkësive lokale fetare në vit?

	N	%
0	5	11.1
0-2	5	11.1
2-4	11	24.4
4-6	10	22.2
Më shumë se 6-të	11	24.4
Missing	3	6.7
Total	45	100.0




Descriptive Statistics					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
12.Sa është numri i takimeve të realizuara mes institucioneve shtetërore dhe bashkësive lokale fetare në vit?	42	1	5	3.40	1.326
Valid N (listwise)	42				

Midis institucioneve shtetërore dhe atyre fetare në nivel lokal, del se, mesatarisht realizohen 3.40 takime në vit.


13.Sa është numri i problematikave të ngritura nga bashkësitë fetare?

Për numrin e problematikave të ngritura në drejtim të institucioneve shtetërore, rezulton se, 30 % (n= 15) e tyre raportojnë 0-2 çështje, 20 % (n=9) nuk raportojnë të jenë ngritur problematika, 16% (n=7) raportojnë 2-4 raste, 18% (n=8) raportojnë më shumë se 6 raste të ngritura nga bashkësitë fetare, 4% (n=2) pa përgjigje, 9% (n=4) janë përgjigjur nuk e di.




14.Sa problematika të drejtuara institucionit tuaj janë zgjidhur përfundimisht?

Ndërsa, përsa i përket zgjidhjes së problematikave të ngritura, të intervistuarit raportojnë në masën 29 % (n= 13) se janë zgjidhur nga 0-2 prej tyre dhe 27% (n=12) nuk është zgjidhur asnjë rast, 7% (n=3) raportojnë 2-4 raste, 16% (n=7) raportojnë më shumë se 6 raste të ngritura nga bashkësitë fetare, 9% (n=4) pa përgjigje, 9% (n=4) janë përgjigjur nuk e di.




15.A ndjeheni të diskriminuar/menjanuar nga shteti?

Për sa i përket çështjes së pranisë së praktikave diskriminuese në marrëdhëniet midis institucioneve shtetërore dha atyre të bashkësive fetare në nivel lokal, rezulton se subjekti pjesëmarrës ka raportuar në masën 89 % (40) negativisht dhe 2% (n= 1) pozitivisht. Ndërsa, 9 % (n= 4) shfaqet si vlerë e humbur, që nënkupton se i intervistuari ka refuzuar të përgjigjet.



16.Mendoni se ka favorizime në marrëdhëniet pushtet vendor-bashkësi fetare?

Nga ana tjetër, po ashtu, i intervistuari raporton në masën 89 % (n= 40) negativisht në lidhje me ekzistencën e praktikave favorizuese midis palëve, 7 % (n= 3) e tyre, raportojnë pozitivisht, ndërsa, 4 % (n= 2) nuk janë përgjigjur.



Konkluzione

Nga tërësia e takimeve/intervistave u krijua ideja fillestare e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndërmjet bashkësive fetare dhe pushtetit vendor, dhe kjo u vërtetua edhe nga pyetësorët e plotësuar. Nga të dyja palët u shpreh marrëdhënia korrekte mes tyre dhe ndihma e marrë në raste të caktuara. Një problem i hasur në të gjitha bashkitë e prefekturës, është kthimi dhe kompesimi i pronave, problem i shprehur si nga bashkësitë fetare ashtu edhe nga pushteti vendor.

Vihet re se, qyteti Vlorës përfaqësohet me nurmin më të madh të pjesëmarrësve në pyetësor, duke u pasuar nga Saranda dhe zona e Delvinës. Rreth 71 % e pjesëmarrësve janë meshkuj dhe pjesa tjetër femra, ku dominon mosha mesatare 36-45 vjec me 31 %. Përfaqësuesit e institucioneve shtetërore përbëjnë 76 % të pjesëmarrësve në plotësimin e pyetësorit dhe ata të bashkësive fetare 22 %. Kjo ndoshta shpjegon dhe faktin që, arsimi i lartë laik ka qenë arsimi i ndjekur nga 85 % e të anketuarve dhe vetëm 11 % arsimi i lartë fetar. Vjetërsia në punë përbën një fakt të rëndësishëm përsa i përket punës me bashkësitë fetare, pasi kjo ndihmon në njohjen më mirë të fushës së veprimtarisë së këtyre bashkësive dhe personave që i drejtojnë ato. Rreth 63% kanë mbi 5 vite punë në detyrë. Por pavarësisht këtij fakti vihet re një nivel mesatar njohjeje i bazës ligjore, sidomos i marrëveshjeve të nënshkruara mes shtetit dhe bashkësive fetare. Vetëm 42 % e të anketuarve e dinë se aktualisht janë 5 bashkësi fetare, 18 % mendojnë se janë 4 bashkësi fetare dhe rreth 20 % nuk janë përgjigjur. Kur vjen puna te organizatat/ shoqatat fetare që operojnë në zonën e tyre, ka një mungesë të plotë informacioni nga të dyja palët. Kjo mund të jetë dhe si pasojë se në disa raste ka kisha ungjillore që nuk janë pjesë e Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë, por edhe sepse një pjesë e mirë e këtyre kishave nuk prezantohen si anëtare të saj. Vetëm rreth 20 % mendojnë se janë 3 organizata/shoqata fetare, 16% nuk janë përgjigjur, ndërsa pjesa tjetër japin përgjigje të ndryshme. Sikurse dhe nga bisedat paraprake dhe nga pyetësorët del se marrëdhëniet mes pushtetit vendor dhe bashkësive fetare janë të mira në nivelin bashkëpunues. Mesatarisht për këtë qark dalin që janë realizuar rreth tre takime në vit. Numri i problematikave të ngritura nga bashkësitë fetare varion në 0-2 problematika me rreth 33%, dhe 29 % raportojnë se janë zgjidhur në favor të bashkësive fetare 0-2 problematika. Si pushteti vendor dhe bashkësitë fetare raportojnë se nuk ka diskriminim apo favorizim mes tyre.

Për dy pyetjet e lira me diskutim, u vu re se, një pjesë kanë deklaruar se nuk kanë çfarë të shtojnë dhe një pjesë, sidomos nga bashkësitë fetare, kërkojnë që të zbatohen ligjet në fuqi si dhe zbatimi korrekt i marrëveshjeve të nënshkruara.

QARKU I BERATIT

Qarku i Beratit përmbledh administrativisht Bashkitë: Berat, Kuçovë, Skrapar, Poliçan, dhe Ura Vajgurore, së bashku me 24 Njësi Administrative. Në nivel institucional, bashkësitë fetare përfaqësohen prej: Myftinisë së Beratit, Skraparit, që i përkasin Komunitetit Mysliman të Shqipërisë; Mitropolisë së Beratit që i përket Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë; Qendrave baritore të Administraturës Apostolike Jugore, që i përkasin Kishës Katolike në Shqipëri, Gjyshatës së Skraparit, që i përket Kryegjyshatës Botërore Bektashiane dhe 5 Kishave të ndryshme që i përkasin Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë.



Ky qark i njohur historikisht për ndjenja të forta besimi, paraqitet me një panoramë fetare të larmishme, të shoqëruar me një përhapje e shtrirje gjeografike të konsiderueshme. Nisur nga kjo, pritshmëritë e nivelit të bashkëpunimit mes pushtetit vendor dhe feve të ndryshme janë të larta.

Duke patur parasysh qëllimin e projektit, modalitetet e zhvillimit të tij në këtë qark, u përqendruan në bisedat e lira dhe në intervistat e semi-strukturuara. U zhvilluan gjithsej 42 takime, prej të cilave u plotësuan në mënyrë vullnetare 52 pyetsorë të cilët trajtohen në vijim.

Në këtë kuadër u mbuluan zonat si mëposhtë:


9. Prefektura Berat
10. Bashkia Berat (7 njësi administrative)
11. Bashkia Ura Vajgurore (4 njësi administrative)
12. Bashkia Kuçovë (3 njësi administrative)
13. Bashkia Poliçan (2 njësi administrative)
14. Bashkia Skrapar (8 njësi administrative)

Nga tërësia e takimeve/intervistave u krijua ideja fillestare e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndërmjet bashkësive fetare dhe pushtetit vendor, dhe kjo u vërtetua edhe nga pyetsorët e plotësuar. Nga të dyja palët u shpreh marrëdhënia korrekte mes tyre dhe ndihma e marrë në raste të caktuara. Një problem i hasur në të gjitha bashkitë e prefekturës, është kthimi dhe kompesimi i pronave, problem i shprehur si nga bashkësitë fetare, por edhe nga pushteti vendor.

ANALIZA E TË DHËNAVE

1.Vendbanimi

Nga 52 persona të intervistuar në këtë qark, rezultojnë se: 32.7 % (n=17) e pjesëmarrësve janë nga Berati, 13.5 % (n=7) nga Ura Vajgurore, 19.2 % (n=10) nga Kuçova, 9.6 % (n=5) nga Poliçani.




2.Gjinia

Përsa i përket gjinisë së pjesëmarrësve në këtë studim, rezulton se, 78.8 % (n=41) janë meshkuj dhe 21% (n=11) janë femra




3.Mosha

Vërejmë se shpërndarja e pjesëmarrësve sipas grupmoshave është: 31% (n=26), i përkasin grupmoshës 25-35 vjeç, 17% (n=9) grupmosha 36-45 vjeç, 21% (n=11) grupmosha 46-55 vjeç, 30.8 % (n=16) grupmosha 56-65 vjeç, dhe 0% (n=0) i përkasin grupmoshës mbi 65 vjeç.




4. Niveli i arsimit

Përsa i përket nivelit të arsimit të pjesëmarrësve në këtë studim, rezulton se, 61 % (n= 32) e tyre kanë kryer arsimin e lartë laik, 23 % (n= 12) arsimin e mesëm laik, 10 % (n= 5) arsim të lartë fetar, 2. % (n= 1) arsim profesional laik, 2. % (n= 1) arsim profesional fetar, 2. % (n= 1) arsim tjetër fetar




5. Institucioni që përfaqëson

Sipas të dhënave të mbledhuara, rezulton se, 64% (n= 33) e pjesëmarrësve përfaqësojnë institucione lokale shtetërore, 35 % (n= 18) e tyre përfaqësojnë institucione lokale të bashkësive fetare dhe, 1.9 % (n= 1) e tyre përfaqësojnë shoqata ose fondacionet fetare.



6. Vitet e përvojës në këtë detyrë

Ndërsa, përsa i përket përvojës në detyrën aktuale që ushtrojnë, rezulton se 8 % (n=4) e pjesëmarrësve kanë përvojë 3-5 vite, 42 % (n= 22) mbi 5 vite, 39 % (n= 20) e tyre kanë 1-3 vite dhe, 11 % (n= 6) kanë më pak se 1 vit përvojë në detyrën që ushtrojnë.



7.

	N	Minimu m	Maxim um	Mean	Std. Deviat ion
7.1.Sa i njohur jeni me të drejtat fetare të garantuara nga Kushtetura e Republikës së Shqipërisë? Ju lutem vlerësoni nivelin e njohurive tuaja me notë nga 1 në 3...	51	1	3	1.98	0.469
7.2.Sa i njohur jeni me marrëveshjet e nënshkruara midis Shtetit dhe bashkësive fetare në vend? Ju lutem vlerësoni nivelin e njohurive tuaja me notë nga 1 në 3...	52	1	3	2.12	0.615
7.3..Sa i njohur jeni me Ligjin Nr. 8788, dt,07.05.2001 'Për Organizatat Jofitimprurëse'? Ju lutem vlerësoni nivelin e njohurive tuaja me notë nga 1 në 3...	51	1	3	2.06	0.614
Valid N (listëise)	50				


Për këtë pyetje matjet janë realizuar me anë të shkallës Likert me tre pikë: (1- Dobët, 2 - Mirë, 3 - Shumë mirë).

- Për pyetjen e parë, e cila kishte për qëllim matjen e njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me të drejtat fetare të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, rezulton se është arritur një mesatare prej 1.98 pikë nga maksimalja e mundshme që ishte 3.
- Për pyetjen e dytë, e cila ka për qëllim matjen e njohurive të pjesëmarrësve për marrëveshjet e nënshkruara midis Shtetit dhe bashkësive fetare, rezulton se mesatarja e përfutur është 2.12 nga 3 që ishte maksimalja e mundshme.
- Ndërsa, për pyetjen e tretë, e cila synon të masë nivelin e njohurive të pjesëmarrësve për Ligjin Nr. 8788, dt,07.05.2001 'Për Organizatat Jofitimprurëse', nëpërmjet të cilit rregullohet aktiviteti i shoqatave dhe fondacioneve me karakter fetar që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vend, rezulton se, mesatarja e përfutur është 2.06 nga 3 që ishte maksimalja e mundshme.

8.Sa është numri i bashkësive fetare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vendin tone

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat statistikore për njohuritë që ka i intervistuari në lidhje me numrin e bashkësive fetare të pranishme në Shqipëri.


		N	%
Valid	1	1	1.9
	4	16	30.8
	5	19	36.5
	6	12	23.1
	Nuk e di	1	1.9
Missing	Missing	3	5.8
Total		52	100.0



9.Sa është numri i organizatave/shoqatave fetare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në zonën tuaj?


Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat statistikore për njohuritë që ka i intervistuari në lidhje me numrin e organizatave/shoqatave fetare të pranishme në Shqipëri.

		N	%
Valid	1	11	21.2
	2	4	7.7
	3	10	19.2
	4	8	15.4
	5	7	13.5
	6	5	9.6
	9	1	1.9
	Total	46	88.5
Missing	System	6	11.5
Total		52	100.0




10. Si i perceptoni marrëdhëniet midis institucioneve shtetërore dhe institucioneve të bashkësive fetare në zonën tuaj? (Ins shtet.) Ju lutem vlerësojini këto marrëdhënie me notë nga 1 në 3...

Nga të dhënat, rezulton se marrëdhëniet mes institucioneve shtetërore kundrejt institucione të bashkësive fetare janë vlerësuar në masën 86 % (n= 45), si marrëdhënie bashkëpunuese, kortezie 10% (n=5) dhe të dobëta 4% (n=2).



11.Si i perceptoni marrëdhëniet midis institucioneve të bashkësive fetare dhe institucioneve shtetërore në zonën tuaj? (Ins fetare.)Ju lutem vlerësojini këto marrëdhënie me notë nga 1 në 3...


Ndërsa, në marrëdhënien mes institucione të bashkësive fetare kundrejt institucione shtetërore janë vlerësuar në masën 90 % (n= 47) si marrëdhënie bashkëpunuese, kortezie 8% (n=4) dhe të dobëta 2 % (n=1).



	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
12.Sa është numri i takimeve te realizuara mes institucioneve shtetërore dhe bashkësive lokale fetare në vit?	50	1	5	3.00	1.088
Valid N (listëise)	50				


12. Sa është numri i takimeve te realizuara mes institucioneve shtetërore dhe bashkësive lokale fetare në vit?

		N	%
Valid	0	3	5.8
	0-2	15	28.8
	2-4	16	30.8
	4-6	11	21.2
	Më shumë se 6-të	5	9.6
Missing	Missing	2	3.8
Total		52	100.0




13. Sa është numri i problematikave të ngritura nga bashkësitë fetare?

Për numrin e problematikave të ngritura në drejtim të institucioneve shtetërore, rezulton se, 44 % (n= 23) e tyre raportojnë 0-2 çështje, 8 % (n=4) nuk raportojnë të jenë ngritur problematika, 19% (n=10) raportojnë 2-4 raste, 4% (n=2) raportojnë 4-6 raste të ngritura nga bashkësitë fetare, 6% (n=3) raportojnë më shumë se 6 raste të ngritura nga bashkësitë fetare, 19% (n=10) pa përgjigje.




15. Sa problematika të drejtuara institucionit tuaj janë zgjidhur përfundimisht?

Ndërsa, për sa i përket zgjidhjes së problematikave të ngritura, të intervistuarit raportojnë në masën 40 % (n= 21) se janë zgjidhur nga 0-2 prej tyre, 29% (n=15) nuk është zgjidhur asnjë rast, 12% (n=6) raportojnë 2-4 raste, 2% (n=1) raportojnë më shumë se 6 raste të ngritura nga bashkësitë fetare, 4% (n=2) pa përgjigje, 13% (n=7) janë përgjigjur nuk e di.




16. A ndjeheni të diskriminuar/mënjanuar nga shteti?

Për sa i përket çështjes së pranisë së praktikave diskriminuese në marrëdhëniet midis institucioneve shtetërore dhe atyre të bashkësive fetare në nivel lokal, rezulton se subjekti pjesëmarrës ka raportuar në masën 92 % (48) negativisht dhe 4% (n= 2) pozitivisht. Ndërsa, 4 % (n= 2) shfaqet si vlerë e humbur, që nënkupton se i intervistuari ka refuzuar të përgjigjet.



16.Mendoni se ka favorizime në marrëdhëniet pushtet vendorë-bashkësi fetare?

Nga ana tjetër, po ashtu, i intervistuari raporton në masën 90 % (n= 47) negativisht në lidhje me ekzistencën e praktikave favorizuese midis palëve,6 % (n= 3) e tyre, raportojnë pozitivisht, ndërsa, 4 % (n= 2) nuk janë përgjigjur.



Konkluzione

Nga tërësia e takimeve/intervistave u krijua ideja fillestare e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndërmjet bashkësive fetare dhe pushtetit vendor, dhe kjo u vërtetua edhe nga pyetësorët e plotësuar. Nga të dyja palët u shpreh marrëdhënia korrekte mes tyre dhe ndihma e marrë në raste të caktuara. Një problem i hasur në të gjitha bashkitë e prefekturës, është kthimi dhe kompesimi i pronave, problem i shprehur si nga bashkësitë fetare ashtu edhe nga pushteti vendor.

Vihet re se, qyteti Beratit përfaqësohet me numrin më të madh të pjesëmarrësve në pyetësor duke u pasuar nga Çorovoda dhe zona e Kuçovës. Rreth 79 % e pjesëmarrësve janë meshkuj dhe pjesa tjetër femra, ku dominon mosha mesatare 25-35 vjec dhe 56-65 vjec me 31 %. Përfaqësuesit e institucioneve shtetërore përbëjnë 64 % të pjesëmarrësve në plotësimin e pyetësorit dhe ata të bashkësive fetare 35 %. Kjo ndoshta shpjegon dhe faktin që, arsimi i lartë laik ka qenë arsimi i ndjekur nga 62 % e të anketuarve dhe vetëm 2 % arsimi i lartë fetar. Vjetërsia në punë përbën një fakt të rëndësishëm përsa i përket punës me bashkësitë fetare, pasi kjo ndihmon në njohjen më mirë të fushës së veprimtarisë së këtyre bashkësive dhe personave që i drejtojnë ato. Rreth 42% kanë mbi 5 vite punë në detyrë. Por pavarësisht këtij fakti vihet re një nivel i ulët njohjeje i bazës ligjore, sidomos i marrëveshjeve të nënshkruara mes shtetit dhe bashkësive fetare. Vetëm 37 % e të anketuarve e dinë se aktualisht janë 5 bashkësi fetare, 31 % mendojnë se janë 4 bashkësi fetare dhe rreth 2 % nuk janë përgjigjur.

Vetëm rreth 19 % mendojnë se janë 3 organizata/shoqata fetare, 12% nuk janë përgjigjur, ndërsa pjesa tjetër japin përgjigje të ndryshme. Sikurse dhe nga bisedat paraprake dhe nga pyetësorët del se marrëdhëniet mes pushtetit vendor dhe bashkësive fetare janë të mira në nivelin bashkëpunues. Mesatarisht për këtë qark dalin që janë realizuar rreth tre takime në vit. Numri i problematikave të ngritura nga bashkësitë fetare varion në 0-2 problematika me rreth 44%, dhe 40 % raportojnë se janë zgjidhur në favor të bashkësive fetare 0-2 problematika. Si pushteti vendor dhe bashkësitë fetare raportojnë se nuk ka diskriminim apo favorizim mes tyre.

Për dy pyetjet e lira me diskutim, u vu re se, një pjesë kanë deklaruar se nuk kanë cfarë të shtojnë dhe një pjesë, sidomos nga bashkësitë fetare, kërkojnë që të zbatohen ligjet në fuqi si dhe zbatimi korrekt i marrëveshjeve të nënshkruara.

QARKU I GJIROKASTRËS

Qarku i Gjirokastrës përmbledh administrativisht Bashkitë: Gjirokastrë, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Këlcyrë dhe Dropull, së bashku me 27 Njësi Administrative. Në nivel institucional, bashkësitë fetare përfaqësohen prej: Myftinisë së Gjirokastrës dhe Përmetit, që i përkasin Komunitetit Mysliman të Shqipërisë; Mitropolisë së Gjirokastrës që i përket Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë; Motrat “Bijat e Krishtit Mbret” të Administraturës Apostolike Jugore, që i përkasin Kishës Katolike në Shqipëri, Gjyshatës së Gjirokastrës, që i përket Kryegjyshatës Botërore Bektashiane dhe 6 Kishave të ndryshme që i përkasin Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë.



Ky qark i njohur historikisht për ndjenja të forta besimi, paraqitet me një panoramë fetare të larmishme, të shoqëruar me një përhapje e shtrirje gjeografike të konsiderueshme. Nisur nga kjo, pritshmëritë e nivelit të bashkëpunimit mes pushtetit vendor dhe feve të ndryshme janë të larta.

Duke patur parasysh qëllimin e projektit, modalitetet e zhvillimit të tij në këtë qark, u përqendruan në bisedat e lira dhe në intervistat e semi-strukturuara. U zhvilluan gjithsej 47 takime, prej të cilave u plotësuan në mënyrë vullnetare 47 pyetsorë të cilët trajtohen në vijim.

Në këtë kuadër u mbuluan zonat si mëposhtë:


1. Prefektura Gjirokastrë
2. Bashkia Gjirokastrë (6 njësi administrative)
3. Bashkia Libohovë (2 njësi administrative)
4. Bashkia Tepelenë (3 njësi administrative)
5. Bashkia Memaliaj (5 njësi administrative)
6. Bashkia Përmet (5 njësi administrative)
7. Bashkia Këlcyrë (3 njësi administrative)
8. Bashkia Dropull (3 njësi administrative)

Nga tërësia e takimeve/intervistave u krijua ideja fillestare e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndërmjet bashkësive fetare dhe pushtetit vendor, dhe kjo u vërtetua edhe nga pyetsorët e plotësuar. Nga të dyja palët u shpreh marrëdhënia korrekte mes tyre dhe ndihma e marrë në raste të caktuara. Një problem i hasur në të gjitha bashkitë e prefekturës, është kthimi dhe kompesimi i pronave, problem i shprehur si nga bashkësitë fetare por edhe nga pushteti vendor.

ANALIZA E TË DHËNAVE


1. Vendbanimi

Nga 47 persona të intervistuar në këtë qark, rezultojnë se: 29.8 % (n=14) e pjesëmarrësve janë nga Gjirokastra, 6.4 % (n=3) nga Libohova, 8.5 % (n=4) nga Dropulli, 17 % (n=8) nga Tepelena, 17% (n=8) nga Memaliaj, 12.8 % (n=6) nga Përmeti, 8.5 % (n=4) nga Këlcyra.




2. Gjinia

Përsa i përket gjinisë së pjesëmarrësve në këtë studim, rezulton se, 78 % (n=37) janë meshkuj dhe 22% (n=10) janë femra




3. Moshë

Vërejmë se shpërndarja e pjesëmarrësve sipas grupmoshave është: 49% (n=23), i përkasin grupmoshës 25-35 vjeç, 12.8% (n=6) grupmosha 36-45 vjeç, 27.7% (n=13) grupmosha 46-55 vjeç, 10.6 % (n=5) grupmosha 56-65 vjeç, dhe 0% (n=0) i përkasin grupmoshës mbi 65 vjeç




4. Niveli i arsimit të kryer

Përsa i përket nivelit të arsimit të pjesëmarrësve në këtë studim, rezulton se, 90 % (n= 42) e tyre kanë kryer arsimin e lartë laik, 2.1 % (n=1) arsimin e mesëm laik, 4.3 % (n= 2) arsim të lartë fetar, 4.3. % (n= 2) arsim profesional laik.




5. Çfarë institucioni përfaqësoni?

Sipas të dhënave të mbledhuara, rezulton se, 75% (n= 35) e pjesëmarrësve përfaqësojnë institucione lokale shtetërore, 20 % (n= 10) e tyre përfaqësojnë institucione lokale të bashkësive fetare dhe, 4.3 % (n= 2) e tyre përfaqësojnë shoqata ose fondacionet fetare.



6. Sa vite përvojë keni në këtë detyrë?

Ndërsa, përsa i përket përvojës në detyrën aktuale që ushtrojnë, rezulton se 17 % (n=8) e pjesëmarrësve kanë përvojë 3-5 vite, 28 % (n= 13) mbi 5 vite, 36 % (n= 17) e tyre kanë 1-3 vite dhe, 19 % (n= 9) kanë më pak se 1 vit përvojë në detyrën që ushtrojnë.



7.

Descriptive Statistics					
	N	Mini mum	Maxi mum	Mean	Std. Deviation
7.1.Sa i njohur jeni me të drejtat fetare të garantuara nga Kushtetura e Republikës së Shqipërisë? Ju lutem vlerësoni nivelin e njohurive tuaja me notë nga 1 në 3...	47	1	3	2.06	0.528
7.2.Sa i njohur jeni me marrëveshjet e nënshkruara midis Shtetit dhe bashkësive fetare në vend? Ju lutem vlerësoni nivelin e njohurive tuaja me notë nga 1 në 3...	46	1	3	2.33	0.598
7.3..Sa i njohur jeni me Ligjin Nr. 8788, dt,07.05.2001 'Për Organizatat Jofitimprurëse'? Ju lutem vlerësoni nivelin e njohurive tuaja me notë nga 1 në 3...	47	1	3	2.13	0.612
Valid N (listëise)	46				


Për këtë pyetje matjet janë realizuar me anë të shkallës Likert me tre pikë: (1- Dobët, 2 - Mirë, 3 - Shumë mirë).

- *Për pyetjen e parë, e cila kishte për qëllim matjen e njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me të drejtat fetare të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, rezulton se është arritur një mesatare prej 2.06 pikë nga maksimalja e mundshme që ishte 3.*
- *Për pyetjen e dytë, e cila ka për qëllim matjen e njohurive të pjesëmarrësve për marrëveshjet e nënshkruara midis Shtetit dhe bashkësive fetare, rezulton se mesatarja e përfutur është 2.33 nga 3 që ishte maksimalja e mundshme.*
- *Ndërsa, për pyetjen e tretë, e cila synon të masë nivelin e njohurive të pjesëmarrësve për Ligjin Nr. 8788, dt,07.05.2001 'Për Organizatat Jofitimprurëse', nëpërmjet të cilit rregullohet aktiviteti i shoqatave dhe fondacioneve me karakter fetar që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vend, rezulton se, mesatarja e përfutur është 2.13 nga 3 që ishte maksimalja e mundshme.*

8. Sa është numri i bashkësive fetare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vendin tonë?

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat statistikore për njohuritë që ka i intervistuari në lidhje me numrin e bashkësive fetare të pranishme në Shqipëri.


		N	%
Valid	2	1	2.1
	3	4	8.5
	4	10	21.3
	5	18	38.3
	6	6	12.8
	Nuk e di	1	2.1
	10	1	2.1
Missing	Missing	6	12.8
Total		47	100.0



9. Sa është numri i orgaizatave/shoqatave fetare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në zonën tuaj?


Në grafikun e mëposhtëm paraqiten të dhënat statistikore për njohuritë që ka i intervistuari në lidhje me numrin e orgaizatave/shoqatave fetare të pranishme në Shqipëri.

		N	%
Valid	1	9	19.1
	2	8	17.0
	3	7	14.9
	4	7	14.9
	5	4	8.5
	Nuk e di	1	2.1
Missing	Missing	11	23.4
Total		47	100.0




10. Si i perceptoni marrëdhëniet midis institucioneve shtetërore dhe institucioneve të bashkësive fetare në zonën tuaj? (Ins shtet.) Ju lutem vlerësojini këto marrëdhënie me notë nga 1 në 3...

Nga të dhënat, rezulton se marrëdhëniet mes institucioneve shtetërore kundrejt institucione të bashkësive fetare janë vlerësuar në masën 64 % (n= 30), si marrëdhënie bashkëpunuese, kortezie 23% (n=11) dhe të dobëta 10% (n=5), nuk janë përgjigjur 2% (n=1),




11. Si i perceptoni marrëdhëniet midis institucioneve të bashkësive fetare dhe institucioneve shtetërore në zonën tuaj? (Ins fetare.) Ju lutem vlerësojini këto marrëdhënie me notë nga 1 në 3...

Ndërsa, në marrëdhënien mes institucione të bashkësive fetare kundrejt institucione shtetërore janë vlerësuar në masën 68 % (n= 32) si marrëdhënie bashkëpunuese, kortezie 17% (n=8) dhe të dobëta 11 % (n=5), pa përgjigje 4% (n=2). .



12. Sa është numri i takimeve të realizuara mes institucioneve shtetërore dhe bashkësive lokale fetare në vit?

		N	%
Valid	0	8	17.0
	0-2	17	36.2
	2-4	10	21.3
	4-6	3	6.4
	Më shumë se 6-të	5	10.6
Missing	Missing	4	8.5
Total		47	100.0




Descriptive Statistics					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
12.Sa është numri i takimeve të realizuara mes institucioneve shtetërore dhe bashkësive lokale fetare në vit?	43	1	5	2.53	1.222
Valid N (listëise)	43				

Midis institucioneve shtetërore dhe atyre fetare në nivel lokal, del se, mesatarisht realizohen 2.53 takime në vit.


13. Sa është numri i problematikave të ngritura nga bashkësitë fetare?

Për numrin e problematikave të ngritura në drejtim të institucioneve shtetërore, rezulton se, 38 % (n= 18) e tyre raportojnë 0-2 çështje, 28 % (n=13) nuk raportojnë të jenë ngritur problematika, 15% (n=7) raportojnë 2-4 raste, 4% (n=2) raportojnë 4-6 raste të ngritura nga bashkësitë fetare, 4% (n=2) raportojnë më shumë se 6 raste të ngritura nga bashkësitë fetare, 4% (n=1) pa përgjigje, 9% (n=4) nuk e di.




14. Sa problematika të drejtuara institucionit tuaj janë zgjidhur përfundimisht?

Ndërsa, për sa i përket zgjidhjes së problematikave të ngritura, të intervistuarit raportojnë në masën 38 % (n= 18) se janë zgjidhur nga 0-2 prej tyre, 36% (n=17) nuk është zgjidhur asnjë rast, 4% (n=2) raportojnë 2-4 raste, 7% (n=3) raportojnë më shumë se 6 raste të ngritura nga bashkësitë fetare, 2% (n=1) pa përgjigje, 9% (n=4) janë përgjigjur nuk e di.




15. A ndjeheni të diskriminuar/mënjanuar nga shteti?

Për sa i përket çështjes së pranisë së praktikave diskriminuese në marrëdhëniet midis institucioneve shtetërore dhe atyre të bashkësive fetare në nivel lokal, rezulton se subjekti pjesëmarrës ka raportuar në masën 81 % (38) negativisht dhe 7% (n= 8) pozitivisht. Ndërsa, 2 % (n= 1) shfaqet si vlerë e humbur, që nënkupton se i intervistuari ka refuzuar të përgjigjet.



16. Mendoni se ka favorizime në marrëdhëniet pushtet vendor-bashkësi fetare?

Nga ana tjetër, po ashtu, i intervistuari raporton në masën 85 % (n= 40) negativisht në lidhje me ekzistencën e praktikave favorizuese midis palëve, 13 % (n= 6) e tyre, raportojnë pozitivisht, ndërsa, 2 % (n= 1) nuk janë përgjigjur.



Konkluzione

Nga tërësia e takimeve/intervistave u krijua ideja fillestare e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndërmjet bashkësive fetare dhe pushtetit vendor, dhe kjo u vërtetua edhe nga pyetësorët e plotësuar. Nga të dyja palët u shpreh marrëdhënia korrekte mes tyre dhe ndihma e marrë në raste të caktuara. Një problem i hasur në të gjitha bashkitë e prefekturës, është kthimi dhe kompesimi i pronave, problem i shprehur si nga bashkësitë fetare, ashtu edhe nga pushteti vendor.

Vihet re se, qyteti Gjirokastrë përfaqësohet me numrin më të madh të pjesëmarrësve në pyetësor duke u pasuar nga Tepelena dhe zona e Memaliajt. Rreth 79 % e pjesëmarrësve janë meshkuj dhe pjesa tjetër femra, ku dominon mosha mesatare 25-35 vjeç me 49 %. Përfaqësuesit e institucioneve shtetërore përbëjnë 75 % të pjesëmarrësve në plotësimin e pyetësorit dhe ata të bashkësive fetare 21 %. Kjo ndoshta shpjegon dhe faktin që, arsimi i lartë laik ka qenë arsimi i ndjekur nga 89 % e të anketuarve dhe vetëm 4 % arsimi i lartë fetar. Vjetërsia në punë përbën një fakt të rëndësishëm përse i përket punës me bashkësitë fetare, pasi kjo ndihmon në njohjen më

mirë të fushës së veprimtarisë së këtyre bashkësive dhe personave që i drejtojnë ato. Rreth 36% kanë 1-3 vite punë dhe 28% kanë mbi 5 vite punë në detyrë. Por pavarësisht këtij fakti vihet re një nivel mesatar njohjeje i bazës ligjore, sidomos i marrëveshjeve të nënshkruara mes shtetit dhe bashkësive fetare. Vetëm 38 % e të anketuarve e dinë se aktualisht janë 5 bashkësi fetare, 21 % mendojnë se janë 4 bashkësi fetare dhe rreth 13 % nuk janë përgjigjur. Kur vjen puna te organizatat/ shoqatat fetare që operojnë në zonën e tyre, ka një mungesë të plotë informacioni nga të dyja palët. Vetëm rreth 15 % mendojnë se janë 3 organizata/shoqata fetare, 23% nuk janë përgjigjur, ndërsa pjesa tjetër japin përgjigje të ndryshme. Sikurse dhe nga bisedat paraprake dhe nga pyetsorët del se marrëdhëniet mes pushtetit vendor dhe bashkësive fetare janë të mira në nivelin bashkëpunues. Mesatarisht për këtë qark dalin që janë realizuar rreth tre takime në vit. Numri i problematikave të ngritura nga bashkësitë fetare varion në 0-2 problematika me rreth 38%, dhe 38 % raportojnë se janë zgjidhur në favor të bashkësive fetare 0-2 problematika. Si pushteti vendor dhe bashkësitë fetare raportojnë se nuk ka diskriminim apo favorizim mes tyre.

Për dy pyetjet e lira me diskutim, u vu re se, një pjesë kanë deklaruar se nuk kanë çfarë të shtojnë dhe një pjesë, sidomos nga bashkësitë fetare, kërkojnë që të zbatohen ligjet në fuqi si dhe zbatimi korrekt i marrëveshjeve të nënshkruara.

Përpunimi dhe analizimi i të dhënave dhe grafiqet analizuese për katër qarqet

Në këtë pjesë të studimit, paraqiten në mënyrë të detajuar shpërndarjet e frekuencave të subjektit pjesëmarrës në pyetësorë.

Siç nënkuptohet edhe nga emërtimi, analiza përshkruese përdoret për të përshkruar të dhënat e mbledhura në studimet kërkimore dhe për të karakterizuar me saktësi çështjet eurvejuara brenda një kampioni specifik.

Analizat përshkruese përdoren shpesh për të përmbledhur një kampion studimi. Kjo, sepse luan një rol të rëndësishëm për sigurimin e informacionit paraprak për përfaqësimin e përgjithshëm të kampionit të studimit, si dhe informacionin e nevojshëm që do të shërbejë për studime tjera të mundshme në të ardhmen. Në përpyekjet e ndryshme kërkimore, sikurse mund të jenë thjesht studime përshkruese, përshkrimi i saktë dhe gjithëpërfshirës i të dhënave të studimit mund të jenë edhe fokusi kryesor i studimit. Në të dy rastet, qëllimi kryesor i analizës përshkruese është që të paraqesë me saktësi shpërndarjen e vlerësimeve të bëra për çështje brenda një grupi të veçantë të të dhënave.

Ekzistojnë një larmi metodash për të ekzaminuar shpërndarjen e një ndryshoreje. Ndoshta metoda më themelore dhe pika fillestare, pothuajse baza e të gjithë analizave statistikore, është shpërndarja e frekuencës.

Analiza e frekuencës është një hap i rëndësishëm që duhet të ndërmerret në fillim të përpunimit dhe analizimit të të dhënave dhe realizohen nëpërmjet përgatitjes së tabelave të shpërndarjes ose frekuencës. Qëllimi dhe ideja e përgatitjes së tabelave të frekuencave është që të tregojë vlerësimin e bërë nga subjekti pjesëmarrës në studim, për secilën variabël. Me "frekuencë" nënkuptohet numri i herëve kur ndodh diçka. Pra, jepet llogaritja e përqindjeve, të cilat na tregojnë përqindjen e rasteve që përmbahen brenda secilës frekuencë. Pra, me nocionin 'frekuencë' nënkuptojmë thjesht një numër që na tregon se sa shpesh ndodh diçka në të dhënat e siguruara, dhe i referohet numrit të vlerës së shfaqur në një kategori të një ndryshoreje dhe rezultateve të sasisë ose masës së një ndryshoreje. Analiza e frekuencës përdoret për të përkufizuar rastin se sa shpesh ndodh diçka në një periudhë kohore të caktuar.


Më poshtë, paraqitet shpërndarja e frekuencave për secilën variabël sipas radhës.

Si fillim, sqarojmë se kampioni pjesëmarrës në këtë studim përbëhet nga gjithsej 210 pjesëmarrës, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe njërive lokale të bashkësive fetare apo dhe shoqatave/fondacioneve fetare, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në rajonin e Jugut të Shqipërisë.

1. Shpërndarja e pjesëmarrësve sipas vendbanimeve


Sikurse është paraqitur edhe në grafikun e mëposhtëm, nga gjithsej 210 pjesëmarrës të cilët kanë pranuar të bëhen pjesë e studimit duke plotësuar pyetësorët, më së shumti, janë nga qyteti i Korçës, Pogradecit, Vlorës, Beratit dhe Gjirokastrës.

Përkatësisht, rezulton se, 12.9 % (n=27) e pjesëmarrësve janë nga Korça, 4.3 % (n=9) nga Maliqi, 3.8 % (n=8) nga Kolonja, 0.5 % (n=1) nga Pusteci, 7 % (n=14) nga Pogradeci, 3.3 % (n=7) nga Devolli, 8.1 % (n= 17) nga Berati, 3.3 % (n=7) nga Ura Vajgurore, 4.8 % (n=10) nga Kuçova, 2.4 % (n=5) nga Poliçani, 6% (n= 13) nga Çorovoda, 6.7 % (n=14) nga Gjirokastra, 1.4 % (n=3) nga Libohova, 1.9 % (n=4) nga Dropulli, 3.8 % (n=8) nga Tepelena, 2.9 % (n=6) nga Përmeti, 1.9% (n=4) nga Këlcyra, 5.7 % (n= 12) nga Vlora, 1.4 % (n=3) nga Himara, 2.9 % (n= 6) nga Selenica, 4.3 % (n=9) nga Saranda, 1.4 % (n=3) nga Konispoli, 3.3 % (n=7), nga Delvina dhe 2.4 % (n=5) nga Finiqi.




1. Shpërndarja e pjesëmarrësve sipas gjinisë

Përsa i përket gjinisë së pjesëmarrësve në këtë studim, rezulton se, 75.2 % (n=158) janë meshkuj dhe 24.8% (n=52) janë femra.




2. Shpërndarja e pjesëmarrësve sipas grupmoshave

Nga ana tjetër, vërejmë se shpërndarja e pjesëmarrësve sipas grupmoshave është: 32.9 % (n= 69) grupmoshës 25-35 vjeç, 22.4 % (n= 47) grupmoshës 36-45 vjeç, 23.3 % (n= 49) i përket grupmoshës 46-55 vjeç, , 20.0 % (n= 42) grupmoshës 56-65 vjeç dhe, 1.4 % (n= 3) i përket grupmoshës mbi 65 vjeç.




3. Shpërndarja e pjesëmarrësve sipas nivelit të arsimit

Po ashtu, sa i përket nivelit të arsimit të pjesëmarrësve në këtë studim, rezulton se, 74.8 % (n= 157) e tyre kanë kryer arsimin e lartë laik, 10.05 % (n= 22) arsimin e mesëm laik, 9.0 % (n= 19) arsim të lartë fetar, 1.9 % (n= 4) arsim të mesëm fetar, 1.9 % (n= 4) arsim profesional laik, 1.0 % (n= 2) kanë kryer arsim tjetër laik, 0.5 % (n= 1) kanë kryer arsim tjetër fetar dhe 0.5 % (n= 1) kanë kryer arsim profesional fetar.




4. Shpërndarja e pjesëmarrësve sipas llojit të institucioneve që përfaqësojnë

Sipas të dhënave të paraqitura në grafikun e mëposhtëm, rezulton se, 69.5 % (n= 146) e pjesëmarrësve përfaqësojnë institucione lokale shtetërore, 26.6 % (n= 55) e tyre përfaqësojnë institucione lokale të bashkësive fetare dhe, 4.3 % (n= 9) e tyre përfaqësojnë shoqata ose fondacionet fetare



5. Shpërndarja e pjesëmarrësve sipas vjetërsisë në detyrë

Sa i përket përvojës në detyrën aktuale që ushtrojnë, rezulton se 45.2 % (n= 95) mbi 5 vite, 26.7 % (n= 56) e tyre kanë 1-3 vite, 11 % (n= 23) e pjesëmarrësve kanë përvojë 3-5 vite dhe 17.1 % (n= 36) kanë më pak se 1 vit përvojë në detyrën që ushtrojnë.



6. Statistikat përshkruese për nivelin e njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me të drejtat fetare të garantuara nga Kushtetuta, marrëveshjet e nënshkruara midis shtetit dhe bashkësive fetare dhe Ligjit për OJF-të

Tabela 1

	Numri	Min	Max	Mesatarja
7.1.Sa i njohur jeni me të drejtat fetare të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë?	208	1	3	2.00
7.2.Sa i njohur jeni me marrëveshjet e nënshkruara midis Shtetit dhe bashkësive fetare në vend?	204	1	3	2.16
7.3..Sa i njohur jeni me Ligjin Nr. 8788, dt,07.05.2001 'Për Organizatat Jofitimprurëse'?	204	1	3	2.12
Valid N (listwise)	199			

Për pyetjet e paraqitura në tabelën 1, matjet janë realizuar me anë të shkallës Likert me tre pikë: (1- Dobët, 2 - Mirë, 3 - Shumë mirë).

Nga rezultatet e arritura, rezulton se, për pyetjen e parë, e cila kishte për qëllim matjen e njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me të drejtat fetare të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, rezulton se, është arritur një mesatare prej 2.00 pikë nga maksimalja e mundshme që ishte 3.

Për pyetjen e dytë, e cila kishte për qëllim matjen e njohurive të pjesëmarrësve për marrëveshjet e nënshkruara midis Shtetit dhe bashkësive fetare, rezulton se mesatarja e përfutur është 2.16 nga 3 që ishte maksimalja e mundshme.


Ndërsa, për pyetjen e tretë, e cila synon të masë nivelin e njohurive të pjesëmarrësve për Ligjin Nr. 8788, dt.07.05.2001 'Për Organizatat Jofitimprurëse', nëpërmjet të cilit rregullohet aktiviteti i shoqatave dhe fondacioneve me karakter fetar që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vend, rezulton se, mesatarja e përfutur është 2.12 nga 3 që ishte maksimalja e mundshme.

8.Sa është numri i bashkësive fetare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vendin tonë?

Në tabelën 2 paraqiten të dhënat statistikore përshkruese për njohuritë që ka subjekti pjesëmarrës në lidhje me numrin e bashkësive fetare të pranishme në Shqipëri.

Nga rezultatet e arritura, vërejmë se, 41.9 % (n= 88) e pjesëmarrësve raportojnë për praninë e pesë bashkësive fetare, 23.08 % (n= 50) për katër, 3.3 % (n= 7) për tre, 11.4 % (n= 24) për gjashtë, 1.9 % (n= 4) shprehen se nuk e dine, 0.5 % (n = 1) e subjektit pjesëmarrës raporton për praninë e dy bashkësive fetare të pranishme në vend, ndërsa 13.8 % (n = 29) kanë preferuar të mos përgjigjen.

Tabela 2: Shpërndarja të dhënave në lidhje me njohuritë për numrin e bashkësive fetare




9. Sa është numri i organizatave/shoqatave fetare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në zonën tuaj?

Në tabelën 3 paraqiten të dhënat statistikore përshkruese për njohuritë që ka subjekti pjesëmarrës në lidhje me numrin e organizatave/shoqatave fetare të pranishme në zonë.

Nga rezultatet e arritura, vërejmë se, 19.5 % (n= 41) e pjesëmarrësve raportojnë për praninë e 3 organizatave/shoqatave fetare, 14.8 % (n= 31) për katër, 11.9 % (n= 25) për pesë, 12.4 % (n= 26) për një, 11.0 % (n= 23) për dy, 3.3 % (n= 7) për gjashtë, 0.5 % (n= 1) shprehen se nuk e dine, 17.1 % (n = 36) kanë preferuar të mos përgjigjen.


Tabela 3: Shpërndarja të dhënave në lidhje me njohuritë për numrin e organizatave/shoqatave fetare




10. Shpërndarja e të dhënave për perceptimin e marrëdhënieve midis institucioneve shtetërore dhe institucioneve të bashkësive fetare në nivel lokal

Perceptimi i marrëdhënieve midis institucioneve shtetërore dhe bashkësive fetare në nivel lokal, u mat në formë kategorike, bazuar në tre nivele: *bashkëpunuese, kortezi dhe dobët*, alternativa të cilat u koduan me 1,2,3 sipas radhës.

Sikurse vërehet edhe në Grafikon e paraqitur mëposhtë, në të cilën paraqiten të dhënat e frekuencave për secilin drejtim të marrëdhënieve midis institucioneve, rezulton se, marrëdhëniet me drejtim *‘institucione shtetërore – institucione të bashkësive fetare’* janë vlerësuar në masën 77.6 % (n= 163), si marrëdhënie bashkëpunues



11. Ndërsa, në marrëdhënien me drejtim *‘institucione të bashkësive fetare – institucione shtetërore’* janë vlerësuar në masën 77.1 % (n= 162) si marrëdhënie bashkëpunuese.




12. Shpërndarja e frekuencave të takimeve midis institucioneve shtetërore dhe institucioneve fetare në nivel lokal

Sa i takon shpeshësisë së takimeve të realizuara midis institucioneve shtetërore dhe atyre fetare në nivel lokal, rezulton se, mesatarisht, realizohen 2.93 takime në vit.


<i>Tabela 4: Statistikat përshkruese për takimet vjetore midis institucioneve</i>				
	Numri	Min	Max	Mesatare
12.Sa është numri i takimeve të realizuara mes institucioneve shtetërore dhe bashkësive lokale fetare në vit?	196	1	5	2.93
Valid N (listëise)	196			

Frekuenca e takimeve vjetore mes institucioneve shtetërore lokale dhe bashkësive fetare




13. Shpërndarja e frekuencave për problematikat e ngritura nga bashkësitë fetare lokale dhe atyre të zgjidhura nga institucionet shtetërore lokale

Në një përmbledhje të përgjithshme të përgjigjeve të subjektit pjesëmarrës për numrin e problematikave të ngritura në drejtim të institucioneve shtetërore, rezulton se, 40.4 % (n= 72) e tyre raportojnë 0-2 çështje, ndërsa, 29.2 % (n=52) nuk raportojnë të jenë ngritur problematika, duke arritur kështu një mesatare prej 2.22 pikësh për numrin e problematikave të ngritura në drejtim të institucioneve shtetërore lokale.



15. Përsa i përket çështjes së pranisë së praktikave diskriminuese në marrëdhëniet midis institucioneve shtetërore dhe atyre të bashkësive fetare në nivel lokal, rezulton se subjekti pjesëmarrës ka raportuar në masën 83.3 % (175) negativisht dhe 9.0 % (n= 19) pozitivisht. Ndërsa, 7.6 % (n= 16) shfaqet si vlerë e humbur, që nënkupton se subjekti pjesëmarrës ka refuzuar të përgjigjet.

Tabela 4: Shpërndarja e frekuencave për perceptimin e diskriminimit në marrëdhënien shtet-fe në nivel lokal



	N	%
Po	19	9.0
Jo	175	83.3
Total	194	92.4
Missing	16	7.6
Total	210	100.0

Nga ana tjetër, po ashtu, subjekti pjesëmarrës raporton në masën 79.5 % (n= 167) negativisht në lidhje me ekzistencën e praktikave favorizuese midis palëve. Ndërsa, 13.3 % (n= 28) e tyre, raportojnë pozitivisht. Ndërsa, 7.1 % (n= 15) shfaqet si vlerë e humbur, që nënkupton se subjekti pjesëmarrës ka refuzuar të përgjigjet.

Tabela 5: Shpërndarja e të dhënave për perceptimin e favorizimeve në marrëdhënien shtet-fe në nivel lokal

	N	%
Po	28	13.3
Jo	167	79.5
Total	195	92.9
Missing	15	7.1
Total	210	100.0



IV) KONKLUSIONE

Rezultatet e kësaj analize tregojnë se, ndër pjesëmarrësit që kanë plotësuar pyetësonin, ka një dominancë të dukshme të meshkujve krahasuar me femrat. Numrin më të madh të të intervistuarve e regjistron qyteti i Korçës, ndërsa më të voglin qytetet e Pustec, Konispol dhe Libohovë. Sa i përket pjesëmarrjes së shtresave shoqërore, shihet se mbizotërojnë përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, gjë që gjen shpjegim jo vetëm për nga forma organizative e bashkësive fetare/shoqatave, por edhe nga mënyra me të cilën ata punojnë. Grupmosha më e spikatur është 25-35 vjeç, ndërsa nga pikëpamja e nivelit arsimor shihet se mbizotërojnë individët me arsim të lartë laik. Një pjesë e vogël e kësaj grupmoshe është me arsim të mesëm laik, e cila përbën kryesisht pjesën e administratës vendore të zonave rurale.

Lëvizjet e shpeshta të punonjësve të administratës shtetërore ndikojnë në dobësimin e marrëdhënieve ndërmjet pushtetit vendor dhe bashkësive/shoqatave fetare, pasi pjesa më e madhe e të intervistuarve kishin një periudhë të shkurtër përvojë në detyrën që ushtronin, e cila varionte nga 3 deri në 5 vjet. Konsolidimi i strukturave të administratës vendore krijon qëndrueshmëri edhe në marrëdhëniet ndërmjet palëve.

Njohuritë mbi bazën ligjore nuk mishëronin nivelin më të lartë të pritshmërive, gjë që reflektohet jo vetëm te punonjësit e administratës, por edhe te përfaqësuesit e bashkësive fetare. Kishte mungesa të theksuara të njohjes së Kushtetutës, të marrëveshjeve të nënshkruara ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare, si dhe të ligjit nr. 8788, dt. 07.05.2011 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, mungesa të cilat nuk të ishin kaq të dukshme, pasi baza ligjore konsiderohet se njihet mirë nga të dyja palët që operojnë në çështjet fetare.

Përveç sa më sipër, gjatë plotësimit të pyetësonit u vu re se, përfaqësuesit e institucioneve vendore/shoqatave/bashkësive fetare, nuk kishin informacionet e nevojshme as mbi funksionin dhe rolin që luan Komiteti Shtetëror për Kultet, si institucioni shtetëror që bashkërendon marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe fesë.

Po ashtu, pushteti vendor dhe bashkësitë fetare rezultojnë të mos kenë njohuri të sakta as mbi numrin e shoqatave/bashkësive fetare që veprojnë në zonën e tyre, megjithëse bashkëpunimi ndërmjet të dyja palëve ka qenë në nivelin e duhur. Për këtë arsye, shihet e rekomandueshme që ata të jenë më shumë të interesuar dhe të vlerësojnë në mënyrën e duhur shërbimet që ofron secila palë. Mbi të gjitha, ky bashkëpunim nuk duhet kufizuar vetëm te rastet e festave apo të nevojave të ndryshme të secilës palë, përkundrazi, veprimtaria e tyre duhet ndërthurur e zgjeruar gjer tek elemente që prekin drejtpërdrejt problemet e përditshme të qytetarëve, duke kontribuar kështu edhe në përmirësimin e cilësisë së jetesës së tyre. Institucionet shtetërore duhet t’i ftojnë përfaqësuesit e bashkësive/shoqatave fetare në takimet që ata zhvillojnë dhe t’i shndërrojnë këta të fundit në aktorë, duke e vendosur fokusin te komuniteti ku jetojnë.

Numri i problemeve të adresuara nga shoqatat/bashkësitë fetare rezulton të jetë jo shumë i lartë. Në më të shumtën e herëve ato kanë gjetur në të vërtetë një zgjidhje, por institucionet shtetërore duhet t'i trajtojnë raste të tilla më me përparësi dhe në kohën e duhur. Trajtimi me seriozitetin e duhur i këtyre çështjeve nga organet e pushtetit vendor do të çojë në shmangien e radhëve të gjata nëpër dyer administratash.

Shumë pozitiv është fakti që bashkësitë fetare/shoqatat nuk ndihen të diskriminuara e as të favorizuara nga institucionet shtetërore. Përfaqësuesit e bashkësive fetare/shoqatave shprehen se funksioni që ata ushtrojnë nuk ka ndikuar që të shihen “me sy tjetër”, por as të marrin ndonjë trajtim të veçantë.

V) REKOMANDIME

Nisur nga sa më sipër, Komiteti Shtetëror për Kultet rekomandon që:

- 1) Të përgatitet një doracak/manual, ku të përfshihen Kushtetuta e Shqipërisë, marrëveshjet e nënshkruara me bashkësitë fetare, ligji për OJF-të, baza ligjore e Komitetit Shtetëror për Kultet etj.. Kjo do të kontribuojë në një njohje më të mirë të legjislacionit dhe të institucioneve shtetërore, si dhe në forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërinstitucionale.
- 2) Në institucionet shtetërore sugjerojmë të ketë një punonjës të posaçëm, i cili të merret me trajtimin e çështjeve fetare, por dhe të shërbejë si pikë kontakti me Komitetin Shtetëror për Kultet.
- 3) Për Projektin nr. 3, që do të përfshijë Shqipërinë e Mesme dhe do të ekzekutohet gjatë vitit 2021 nga KSHK, marrja e të dhënave të bëhet në sistem kapilar, deri në njësitë më të vogla administrative. Kjo do të jete një shtysë për përmirësimin e përpjekjeve institucionale në forcimin e bashkëpunimit në nivel vendor.